



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 27 prill 2022, në mbledhjen e IV-të (katërt) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr.52, ndërtesa e re e Komunës, dhe filloi në orën 13:35.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht Kryesues i këtij Komiteti. Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Naim Çunaku, Qëndrim Softolli, Arnisa Sylejmani, Adelinë Stublla, Florent Hasani, Sebastina Vokri, Bashkim Sylja dhe Mrika Thaçi.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje i pranishëm ishte edhe; Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, Leutrim Krasniqi U.D. drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM, Vigan Salihu U.D. drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE, Pajtim Balaj U.D. drejtor i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS, Avni Fetahu U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA .

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbar në këtë mbledhje. Konstatoi kuorumin dhe ftoj nëse ka të interesuar për të marrë fjalën.

z.Naim Çunaku, theksoi, duke marrë parasysh që materiali për seancën e radhës më datë 29.04.2022, është një material bukur i gjerë që besa te raporti financiar vjetor ne kemi pas një plan të punës të miratuar edhe pse unë nuk kam qenë mbështetës i atij plani dhe në atë plan ka qenë e paraparë që raporti financiar të kryhet në muajin mars. Në rregulloren e punës së Kuvendit që po përmendet shumë rregullorja është e përcaktuar që një datë mund të lëviz maksimalisht 7 ditë dhe këtu kemi lëvizje jo ditore por mujore. Sigurisht se ka arsye të për atë punë pse ka ndodh, nuk e kam telashe pse ka ndodh se fundja është një raport i vitit të kaluar, mirëpo ajo çfarë më shqetëson mua dhe dua ta ngris si çështje nëse e kam edhe përkrahjen e kolegëve tjerë që janë anëtarë të KPF-së, që kjo mbledhje të ndahet në dy pjesë dhe atë duke u bazuar në pikat e rendit të ditës të cilat dojnë një trajtim të veçantë, mos të themi një studim të tyre andaj propozoj që të ndahet në dy pjesë ky material për dy seanca që nënkupton të vazhdojë kjo seancë e Kuvendit e mos të thirret seancë e re dhe të ndahen pikat e rendit të ditës , qofshin 6 pika të rendit të ditës njëherë pastaj 6 pika të rendit të ditës në vazhdim, varësisht prioritetit të tyre, kishte me qenë praktikë e mirë e që besoj se praktikohet gjithandej territorit të Republikës së Kosovës, e di që me ligjin për vetëqeverisje lokale rendin e ditës e bënë Kryesuesi në bashkëpunim me Kryetarin por kishte me qenë më mirë që kur kemi mbledhje të inkorporohen të gjithë përfshirë edhe grupet e këshilltarëve të subjekteve që e përbëjnë Kuvendin dhe të harmonizojnë pikat e rendit të ditës dhe ta kemi një dakordim për një Kuvend të punës. Është praktikë e dëshiruar dhe nuk e obligon Kryesuesin dhe Kryetarin e Komunës mirëpo kishte me qenë një praktikë e mirë për një qeverisje të mirë, andaj po e

përmbylli dhe propozoj që këto pika të rendit të ditës të ndahen në dy pjesë prej datës 29.04.2022 dhe ashtu siç dakordohemi për pjesën tjetër që do vazhdoj qoftë më datë 30.05.2022 apo në ditët në vijim. Mos të keqkuptohemi kjo të jetë vazhdim i seancës jo thirrje e seancë e re dhe pagesë e re por të vazhdojë kjo seancë dhe mos të ketë mëditje tjera, vetëm se t'i kontribuojmë më shumë sqarimit gjegjësisht përpunimit të materialit në mënyrë qysh na ka hije.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse dikush nga ju dëshiron të merr fjalën urdhëroni nëse jo atëherë propozimin e z.Naim Çunaku për ndarjen e rendit të ditës në dy pjesë dhe vazhdimin e seancës për pjesën tjetër në një ditë tjetër e hedhim në votim, nëse dëshironi fjalën atëherë urdhëroni.

z.Florent Hasani, theksoi, në këtë seancë të vazhdojmë sipas materialit dhe rendit të ditës mirëpo herën tjetër të kemi parasysh përmbajtjen e materialit sepse përmbajtja e materialit është shumë e ngarkuar dhe produktiviteti i seancës ndoshta është shumë i mangët sepse përmban shumë pika të rendit të ditës për të vazhduar kështu kështu me praktikën e kaluar. Me marrëveshje me Kryesuesin edhe këtë radhë të vazhdojmë seancën sipas thirrjes dhe materialit mirëpo seancat tjera rendi i ditës mos të kalojë më shumë se 10 pika nëse është në rregull.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, edhe unë e di se rendi i ditës është shumë i ngarkuar, fjalën ia kaloj z.Bashkim Syla.

z.Bashkim Syla, theksoi, nëse ka mundësi ekzekutivi të shohë të arsyeshme dhe ta heq ndonjë pikë nga rendi i ditës për këtë seancë në mënyrë që të parashihen ato pika për seancën e ardhme dhe kështu do të lehtësohej puna e këtij komiteti, do të ishte mirë që edhe kjo seancë të vazhdojë kështu kurse seancat tjera me pas kujdes. Sa i përket planit të punës për muajin mars duke e ditë se ka qenë seancë e jashtëzakonshme për këtë arsye është shtyrë kjo pikë e rendit të ditës të cilën e ceku z.Naim Çunaku.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, sa për sqarim ne në muajin mars e kemi mbajtur një seancë të jashtëzakonshme mirëpo ajo s'ka qenë pengesë që në muajin mars ne ta mbajmë edhe një seancë tjetër, mirëpo arsyeja ka qenë se ne e kemi pritur hartën zonale deri sa është miratuar nga ana e ministrisë kompetente. Ne disa herë kemi pritur se brenda 2 ose 3 dite do të miratohet harta zonale, andaj pa miratimin e saj ne nuk kemi mundur të veprojmë sepse prioritet i prioritetëve ka qenë harta zonale, andaj gjatë gjithë kësaj kohe janë grumbulluar edhe pika tjera të rendit të ditës, që ndoshta edhe shumë rregullore nuk e kishin arritur afatin që të kalojnë në Kuvend. Unë kam kërkuar nga drejtorët këtë po e them haptas që disa pika të propozuara për rend dite mos të hyjnë si pika të rendit të ditës mirëpo kërkesa e tyre ka qenë që t'i kemi si pika të rendit të ditës dhe t'i përfundojmë.

z.Naim Çunaku, theksoi, jo qëllim polemikës por fundja merreni përgjigjen si të doni z.Bashkim Syla, por fundja një pjesë të përgjigjes e dha vet Kryesuesi, kur unë thash se në muajin mars ka qenë në plan të punës, planin e punën e kemi të gjithë ashtu siç është. Seancat e jashtëzakonshme nuk mund të parashihen, seancat e jashtëzakonshme varen dhe thirren prej rrethanave të caktuara të jashtëzakonshme dhe aspak nuk mund të lidhet një seancë e rregullt që është e planifikuar me planin e punës dhe të dalë jashtë rendit të planifikuar me planin e punës nga një seancë e jashtëzakonshme, për mua ky s'është arsyetim dhe pajtohem pjesërisht me atë që tha më parë Kryesuesi.

z.Bashkim Syla, theksoi, një sqarim të gjithë, ne e dimë që plani i punës nuk është përfundimisht i pa ndryshuar sepse ai mund të ndryshohet dhe të hyjnë pika të reja të rendit të ditës të propozuara nga ekzekutivi, unë mendoj nëse ka mundësi ndonjë pikë e rendit të ditës që nuk është urgjente të hiqet nga ekzekutivi në mënyrë që të lehtësohet puna për seancën e ardhshme të Kuvendit të caktuar të mbahet në ditën e premte përndryshe ne jemi për që të vazhdohet mbledhja siç është përcaktuar në materialin dhe thirrjen e kësaj mbledhje.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, kam një propozim në qoftë se ne fillojmë me punë dhe nuk arrijmë t'i përfundojmë gjitha pika rendit të ditës atëherë e ndërpreme mbledhjen dhe vazhdojmë punën ditën e nesërme me pikat e rendit në vijim.

z.Qendrim Softolli, theksoi, ne mund t'i paraprijmë kësaj dhe propozimin e z.Naim Çunaku ta miratojmë që seanca të ndahet në dy pjesë dhe pjesa e ndarë të jetë vazhdimësi e kësaj seance për një ditë tjetër qoftë pas dy ose tri dite nuk besoj se do të ketë kurrfarë problemi.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse dikush dëshiron ta marrë fjalën rreth propozimit të z.Naim Çunaku, që mbledhja e Kuvendit të ndahet në dy pjesë urdhëroni.

z.Naim Çunaku, theksoi, sa për sqarim KPF-ja nuk është organ vendimmarrës por ne në këtë Komitet vetëm i sugjerojmë Kuvendit dhe sugjerimi im ke që t'i sugjerojmë Kuvendit që mbledhja të ndahet në dy pjesë pastaj Kuvendi vendos pavarësisht propozimit tim.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, atëherë propozimin e z.Naim Çunaku, që mbledhja e Kuvendit e caktuar të mbahet më 29 prill 2022 të ndahet në dy pjesë duke përfshirë ndarjen e pikave të rendit të ditës dhe pjesa e ndarë të jetë vazhdimësi e kësaj mbledhje ashtu siç dakordohemi për pjesën tjetër që do të vazhdoj qoftë më datë 30.05.2022 apo në ditët në vijim si pjesë e kësaj mbledhje për shkak të përmbajtjes voluminoze të materialit dhe rëndësisë së pikave të rendit të ditës të proceduara për këtë mbledhje.

Propozim ky i cili nuk mori votat e mjaftueshme ngase nga 9 anëtarët e KPF-së, 4 vota ishin PËR dhe 5 Vota ishin KUNDËR.

z.Naim Çunaku, theksoi, mendova se edhe këtë herë Kryesuesi do ta ruaj neutralitetin e tij që i takon por nuk ndodhi.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, isha në dilemë që mos të votoj por për arsye që mos të bllokohet procesi pasi që ishin votat e barabarta, votova për në mënyrë që të vazhdojë procesi tutje, sa i përket rendit të ditës e kam një propozim i cili sipas rregullores duhet të hyjë në rishqyrtim si pikë e rendit të ditës që do të thotë se në kuadër të rendit të ditës po e shtojmë edhe një pikë, këtë po e them me keqardhje se arsyeje pse nuk është proceduar në mënyrë të rregullt është se shkresa e MPL-së, ka ardhë në email adresë të Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Komunës dhe Sekretarisë së Kuvendit më datë 19.04.2022. Fjala është për vendimin e Kuvendit të Komunës së Podujevës të datës 28.02.2022, ku sipas të cilit ndryshohet dhe plotësohet destinimi i objektit pushimorja për nxënës dhe fëmijë bonjak në fshatin Orllan. Ministria e Mjedisit ka vlerësuar se vendimi është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe njëkohësisht ka dhënë arsyetimin në shkresën përkatëse, këtu Ministria na ka kthyer një shkresë pas kalimit të afatit prej 15 ditësh, kështu që edhe kjo pikë duhet të hyjë në rishqyrtim si pikë e rendit të ditës si pika e 17.

z.Naim Çunaku, theksoi, po shihet se në mbledhjen e datës 28.03.2022, kishim një mbledhje të Kuvendi të ngjashme me këtë me shumë pika të rendit të ditës dhe të gjitha ato pika kaluan ashtu siç kaluan dhe 3 pika nga ajo mbledhje kthehen nga MAPL në kundërshtim me ligjin prandaj apeli im më parë ishte që mos të grumbullohen pikat dhe mos të ngutemi por të marrim një vendim çfarë na takon se fundja kur shqyrtohet një vendim aty nuk ka subjekte politike qoftë PDK, LDK, apo LVV, por figuron vetëm Komuna e Podujevës dhe nuk kisha dashur që Kuvendit tim t'i kthehen vendimete jashtëligjshme. Fundja nëse është afati 30 ditë nga ana e Ministrisë për përgjigje të vlerësimit të ligjshmërisë apo 15 ditë veç mos e ndalni deri në 18 ditë.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, ky vendim duhet të rishqyrtohet dhe ne duhet ta rekomandojmë si pikë të rendit të ditës sipas materialit që kemi e të cilin po ua shpërndajmë. Tani para jush kemi vendimin e Ministrisë së Pushtetit Lokal e cila këtë vendim ia ka dërguar Ministrisë së Mjedisit për rishqyrtim kështu që vendimi është i Ministrisë së Mjedisit.

z.Naim Çunaku, theksoi, vetëm një sqarim nëse bën i nderuari z.Kryesues, të gjitha vendimet që kthehen autoritet për shqyrtimin e tyre gjegjësisht se a janë konfitablie rregulloret dhe ligjet në fuqi

është Ministria e Pushtetit Lokal, mirëpo ata nuk janë specialistë për të gjitha fushat dhe vendimet i dërgojnë te Ministrinë e linjës përkatëse për ç' do tematikë që ka të bëjë me to dhe si rezultat i saj kemi përgjigje prej një ministrie tjetër që prapë kalon përmes autoritetit të MPL-së.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse nuk ka tjerë të interesuar për ta marrë fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës atëherë propozoj që në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje të përfshihet Rishqyrtimi i vendimit nr.prot.01-354/02-0014599/22 datës 28.02.2022 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.01-354/02-0087371/18, të datës 02.11.2018, konform Shkresës nr. DL 1546-2/22 datë 25.03.2022, të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Me 5 vota PËR, asnjë votë Kundër dhe 4 vota të Përmbajtura, mbështetet propozimi i Kryesuesit të Kuvendit që në kuadër të rendit të ditës për këtë mbledhje të përfshihet edhe Rishqyrtimi i vendimit nr.prot.01-354/02-0014599/22 datës 28.02.2022 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.01-354/02-0087371/18 datë 02.11.2018, konform Shkresës nr. DL 1546-2/22 datë 25.03.2022 të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, kjo për shkak se me Shkresën në fjalë jemi njoftuar përmes e-mailit pas dërgimit të thirrjes dhe materialit të mbledhjes.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, në vazhdim e vë në votim rendin e ditës duke përfshirë edhe pikën e shtuar për këtë rend dite rishqyrtimi i vendimit nr.prot.01-354/02-0014599/22 datës 28.02.2022 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.01-354/02-0087371/18 datë 02.11.2018

Pas votimit të rendit të ditës në tërësi, nga numri prej 9 anëtarëve të Komitetit, 5 vota janë PËR ndërsa të tjerët nuk morën pjesë në votim, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se miratohet rendi i ditës sipas thirrjes dhe materialit të kësaj mbledhje, përfshirë edhe pikën shtesë;

- **Rishqyrtimi i vendimit nr.prot.01-354/02-0014599/22 datës 28.02.2022 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.01-354/02-0087371/18 datë 02.11.2018**

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa- KPF të mbajtura më: 25 shkurt 2022; dhe 15 mars 2022.

Njëzëri pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohen procesverbalet sipas kësaj pike të rendit të ditës dhe materialit përkatës të dërguar.

2. Propozim Vendimi për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës për periudhën 2022- 2030

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës materialin ua kemi përcjellë dhe nga një CD në selitë e subjekteve politike të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës së Podujevës, andaj besoj se të gjithë materialin e keni marrë dhe e keni konsultuar dhe jeni informuar lidhur me hartën zonale e lidhur me këtë çështje fjalën i kaloj drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

z.Leutrim Krasniqi, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM, theksoi, sa i përket hartës zonale po besoj se i keni marrë materialet të cilat ua kemi dërguar duke përfshirë pjesën grafike dhe pjesën tekstuale që e elaboron në hollësi të gjitha elementet të cilat janë përfshirë në hartën zonale për kushtet ndërtimore për tërë territorin e Komunës së Podujevës, pas mbajtjes së dëgjimeve publike ashtu edhe javën e kaluar është mbajtur edhe një prezantim i hollësishëm

për të treguar më saktë elementet gjithëpërfshirëse që janë jetësore dhe janë të përfshira në këtë draft të hartës zonale, andaj propozoj që këtë pikë ta procedojmë më tutje në seancën e ardhshme të Kuvendit.

z.Naim Çunaku, theksoi, pa dashur ta zgjasë debatin se jemi në muajin e shenjët të ramazanit, është e vërtetë që ndoshta njëri prej vendimeve më të rëndësishme që merren në Kuvend është edhe ai për hartën zonale, unë kam pas rastin të bisedoj edhe me drejtorin dhe e vërteta që e kam thënë dhe mendoj se është ashtu sa i përket hartës zonale është se një ekzekutiv dhe një asamble tjetër kanë marrë vendim dhe kanë votuar që draft harta zonale të dal në diskutim publik një version tjetër dhe në diskutim publik ka qenë e drejtë e tyre dhe kanë dhënë lejen që të del ai draft në diskutim publik madje edhe në kohë të fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale. Mendoj se një dokument shumë i rëndësishëm si harta zonale që paraqet perspektiven ndërtimore dhe zhvillimore të Komunës e të njëjtën kohë impakt të drejtëpërdrejtë ka edhe me vetë qytetarin dhe sa kemi arrit që qytetarin ta njoftojmë për çështjet kryesore që kanë të bëjnë me menaxhimin e pasurive qoftë të pronave bujqësore apo pronave në të cilat do të bëhen ndërtime. Këtu mendoj se nuk e kemi arrit qëllimin apo nuk kemi bërë sa duhet, drejtori e përmendi se ka pas një takim informues e që është e vërtetë se është instaluar një praktikë e re në takime informuese, unë kam pritur duke e pas parasysh që jemi një përbërje e re e Kuvendit që do ta kemi një takim pune apo një punëtori të organizuar prej ndonjë OJQ-je pa dashur përfshirjen e elementeve politike apo nga njerëz neutral sa i përket aspektit politik kam dashur që një OJQ, të na njoftoj për detalet e hartës zonale se ne e dimë se kapacitetet tona si këshilltarë komunal nuk jemi të zgjedhur në bazë të konkursit që t'i kemi gjitha profilet e ndryshme dhe unë mendoj se kemi mungesë të njohurive sa i përket hartës zonale shtu këtu edhe atë që e kam thënë atë ditë kur është miratuar projektbuxheti për këtë vit si vërejtje ndaj kodit buxhetor gjegjësisht funksionalitetit të plotë të Kuvendit. Ligji për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, i ka paraparë këto pengesa që mund të hasim në një pjesë nga numri i 35 asamblistëve sepse të gjithë nuk mund të jenë jurist apo ekonomistë dhe nuk kemi njohuri rreth fushave të caktuara, mirëpo ligji për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, ka paraparë që Kuvendi Komunal t'i ketë organet apo komitetet ndihmëse, konsultative që ne për fat të keq nuk e kemi themeluar ende asnjërin prej tyre dhe po e përmbylli me këtë se edhe sot kam dilema dhe kisha dashur nga drejtori sqarime sa i përket draftit siç ka qenë harta zonale e vitit të kaluar e që ka marrë pëlqimin e ministrisë përkatëse dhe ka ardhë në Kuvend dhe ka dal në dëgjim publik, ndërsa herën tjetër ndryshohet ajo hartë zonale në segmente të caktuara por jo krejtësisht a do të thotë që kjo hartë zonale është kthyer në pikën zero (0) dhe ish dashtë që ky draft të dalë edhe njëherë në diskutim publik për të gjitha ato ndryshime të cilat kanë ndodhë e për të cilat qytetarët nuk i dinë. Këto ndryshime mund t'i dimë në bazë të materialeve por jo përmes debateve publike me qytetarë.

z.Leutrim Krasniqi, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM, theksoi, u përmenden pak a shumë ndryshimet nga draftet paraprake duke pas parasysh është e vërtetë se ka pas një pëlqim sa i përket draftit të hartës zonale të vitit 2020, mirëpo nga drafti aktual me këtë draftin që e kemi ne nuk është se ka ndryshime esenciale pak a shumë janë bërë vetëm ndryshime të cilat janë në të mirë të qytetarëve, dy ndryshime që ndoshta janë më esenciale më të nevojshme janë pjesa ose zgjerimi i zonës urbane. Është zgjeruar kufiri i zonës urbane njashtu një tjetër ndryshim i rëndësishëm që ka ndodh është zgjerimi i kufiri i zonës ndërtimore duke përfshirë bizneset e ndryshme të cilat pak a shumë kanë një trend të zhvillimit përgjatë magjistrales Prishtinë – Podujevë, në qoftë se e analizojmë në detale draftin paraprak me draftin që ju e keni nuk është që mund të themi se ka ndryshime të mëdha. Ndryshimet mund të jenë 5% jo ndoshta me ndonjë përqindje (%) më të madhe, sa i përket prezantimit po më vjen keq që ndoshta nuk keni pas mundësi të vini, mirëpo të gjithë të tjerët që kanë ardhë jam munduar në detaje për të gjitha çështjet që kanë qenë të interesuar ju kam treguar dhe i kam informuar njashtu sa i përket edhe pjesëve tjera që përmendët edhe shqyrtimin publik po besoj se nuk është e nevojshme sepse nuk është se ka ndryshime rrënjësore që me thënë se është diçka komplet e kundërt,

pse nuk është e nevojshme sepse edhe në bazë të ligjeve që janë dhe normat teknike të planifikimit hapësinor si dhe udhëzimet për planifikimet hapësinore për ndërtim nuk na lejojnë të dalim jashtë konditave ose me realizuar diçka komplet të kundërt por duke shkuar çdo herë në bazë të ligjeve që janë në harmoni me planifikimin hapësinor.

z.Naim Çunaku, theksoi, ajo që unë e potencova ishte me qëllimin më të mirë, sa është anë thelbësore është edhe formalitet në jemi dëshmitar të gjithë kësaj kur kemi me konsultuar publikun si qytetar dhe jam shumë i vetëdijshëm se jemi shumë larg nga ajo që dëshirojmë të jetë një qytetari aktive, mirëpo duke pas parasysh që një hap i ndan nga procedura e cila aplikohet kam frikë se ky dokument edhe njëherë mund të na kthehet si diçka jo e ligjshme, në kuptimin e asaj se në atë moment kur ai dokument është prek dhe ka ardhë diçka tjetër, këtë krejt e pata si sqarim pa dashur që ky dokument të na kthehet prapë, por nëse ndodhë që ky dokument të kthehet prapë fundja është përgjegjësia që ti po thua jemi në rregull dhe atëherë jemi në rregull.

z.Leutrim Krasniqi, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, theksoi, sa i përket edhe njëherë pjesës që ky dokument ka mundësi të kthehet, në këtë aspekt po besoj se përkujdeset edhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor pse; sepse ata paraprakisht e kanë dhënë një pëlqim që draftin aktual të cilin ne e kemi është në rregull dhe i plotëson të gjitha konditat, kështu që në rast se kthehet ky dokument si i jashtëligjshëm neve nuk na takon përgjegjësia por i takon Ministrisë që ka dhënë një pëlqim që drafti është në rregull dhe është konform ligjeve të planifikimit hapësinor.

znj.Adelina Stublla, theksoi, në grupi i LVV-së e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës dhe njëherit i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim.

z.Leutrim Krasniqi, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM, theksoi, i ftoj të gjithë anëtarët e Kuvendit që ta votojnë këtë pikë të rendit të ditës në seancën e ardhshme, arsyeja kryesore është se harta zonale me të vërtetë është e nevojshme që komuna jonë ta ketë një dokument të tillë na shërben ose të themi të kemi një ligj për zhvillimin hapësinor se tani ne shohim se në çdo vend në çdo fshat në çdo hapësirë po kemi një zhvillim të degraduar, përfshirë edhe hapësirat në fshatin Batllavë si dhe për hapësirat e tjera. Kështu që për t'i dhënë një instrument kontrollues harta zonale është më se e nevojshme për kohën aktuale në të cilën ne po jetojmë.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse s'ka tjerë të interesuar për të marrë fjalën atëherë e vë në votim edhe këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar.

Pas votimit, me 5 vota PËR, ndërsa të tjerët nuk morën pjesë në votim, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të kësaj pike sipas materialit përkatës të dërguar.

3. Propozim Vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2021 në vitin 2022 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, vlera buxhetore prej 1,032,341.89€, janë mjete nga të hyrat vetanake të cilat nuk janë shpenzuar në vitin 2021, dhe ky dokument duhet të kalojë përmes asamblesë komunale në mënyrë që të barten këto mjete. Këtu keni edhe specifikacionin e projekteve, ndoshta vlen të ceket në këtë mbledhje të KPF-së se të gjitha këto projekte janë projekte në realizim e sipër ku ka kontrata të cilat janë në përmbyllje sepse tani me fillimin e stinës së pranverës fillojnë punimet dhe financiarisht mbyllen ato kontrata andaj propozoj që kjo pikë e rendit të ditës të kalojë në Kuvend për miratim në mbledhjen e radhës.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse s'ka tjerë të interesuar të Komitetit për ta marrë fjalën atëherë e vë në votim edhe këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar.

Pas votimit, me 5 vota PËR, ndërsa të tjerët nuk morën pjesë në votim, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të kësaj pike sipas materialit përkatës të dërguar.

4. Propozim Rregullorja për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve - Raporti nga diskutimi publik

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, rregullorja për ndarjen e subvencioneve i ka kaluar procedurat e dëgjimit publik, është mbajtur dëgjimi publik janë dhënë vërejtjet dhe sugjerimet nga ana e pjesëmarrësve të interesuar dhe kemi bërë] përpjekjet maksimale që të inkorporohen në këtë rregullore dhe këtë pikë të rendit të ditës i propozojmë Kuvendit për miratim në seancën e radhës.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse s'ka tjerë të interesuar të Komitetit për ta marrë fjalën atëherë e vë në votim edhe këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar.

Pas votimit, me 5 vota PËR, ndërsa të tjerët nuk morën pjesë në votim, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të kësaj pike sipas materialit përkatës të dërguar.

5. Propozim Rregullorja për funksionimin e institucioneve edukative-arsimore të Komunës së Podujevës - Raporti nga diskutimi publik

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, theksoi, para jush keni Propozim Rregulloren për funksionimin e institucioneve edukative-arsimore, e keni edhe raportin nga diskutimi publik është një fat i mirë që në këtë raport kanë marrë pjesë një numër i madh i qytetarëve edhe përmes formës elektronike por edhe përmes takimit zyrtar që e kemi pas me drejtor shkollash dhe me qytetarë dhe ka prodhuar një raport besoj që i kemi inkorporuar një varg sugjerimesh në këtë rregullore, presim nga ju që ta përkrahni si rekomandim për Kuvend.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse s'ka tjerë të interesuar të Komitetit për ta marrë fjalën atëherë e vë në votim edhe këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar

Pas votimit, me 5 vota PËR, ndërsa të tjerët nuk morën pjesë në votim, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të kësaj pike sipas materialit përkatës të dërguar.

6. Propozimi për nisjen/inicimin e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale (NPL) në Komunën e Podujevës

z.Vigan Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE, theksoi, para jush keni dokumentin për inicimin e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale (NPL) në

Komunën e Podujevës, të bashkëngjitur keni edhe arsyeshmërinë e propozim vendimit andaj pres nga ju që ta përkrahni këtë propozim.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse s'ka tjerë të interesuar të Komitetit për ta marrë fjalën atëherë e vë në votim edhe këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar

Pas votimit, me 5 vota PËR, ndërsa të tjerët nuk morën pjesë në votim, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të kësaj pike sipas materialit përkatës të dërguar.

7. Propozim Vendimi për themelimin dhe përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi KKSB në Komunën e Podujevës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi KKSB në Komunën e Podujevës, themelohet me vendim të Kryetarit, mirëpo neve na mungon një anëtar i KKSB-së e i cili do të plotësohet pas zgjedhjes së Kryesuesit të Komitetit për Komunitete i cili sipas rregullativës ligjore është anëtar edhe i KKSB-së, nëse dikush nga ju dëshiron ta merr fjalën lidhur me këtë pikë të rendit të ditës urdhëroni nëse jo atëherë edhe këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar e hedh në votim.

Pas votimit, me 5 vota PËR, ndërsa të tjerët nuk morën pjesë në votim, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të kësaj pike sipas materialit përkatës të dërguar.

8. Propozim Rregullorja për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës Sportive “Hakif Zejnullahu” në Podujevë

- Propozim vendimi për vënie në diskutim publik

z.Pajtim Balaj, drejtor i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS, theksoi, ky është një propozim vendim për vënie në diskutim publik për mënyrën e shfrytëzimit të palestrës sportive. Palestra sportive është ndërtuar moti mirëpo asnjëherë nuk është nxjerrë ndonjë rregullore për të, kjo rregullore në të ardhmen do të vlej edhe për palestrën tjetër e që shpresojmë se do të ndërtohet së shpejti posa t'i zgjedhim disa konteste pronësore. Propozimi është vënie në diskutim publik, pjesa e tarifimit dhe pagesave për shfrytëzimin e palestrës janë të inkorporuar në rregulloren për taksa tarifa dhe gjoba komunale e cila do të prezantohen më vonë nga drejtori i DBF-së.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse s'ka anëtar tjerë të interesuar të Komitetit për ta marrë fjalën atëherë e vë në votim edhe këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar

Pas votimit, me 5 vota PËR, ndërsa të tjerët nuk morën pjesë në votim, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të kësaj pike sipas materialit përkatës të dërguar, dhe që në mbledhjen e Kuvendit të propozohet kohëzgjatje e diskutimit publik përfshirë edhe datën/at e debatit/eve publike.

9. Propozim Rregullorja për taksa tarifa dhe gjoba komunale

- Propozim vendimi për vënie në diskutim publik

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, Komuna e Podujevës e ka një rregullore aktuale për taksa tarifa dhe gjopa komunale mirëpo është konsideruar se kjo rregullore duhet t'i p[soj disa ndryshime, është bërë grupi punues dhe janë bërë disa ndryshime dhe ky është propozim vendim për vënie në diskutim publik andaj nga ana juaj presim vërejtjet dhe sugjerimet.

z.Qendrim Softolli, theksoi, do të ndërlihem te rregullorja, sa i përket taksave e dimë që vitin e kaluar janë falë borxhet të cilat janë tarifuar për vite dhe janë grumbulluar, e dimë se shumë problem është edhe inkasomi i tyre sepse ju keni një metodë tjetër të inkasimit dhe nuk keni pas nevojë t'i falni ato borxhe, është dashur ta keni mënyrën e inkasimit dhe grumbullimin e atyre mjeteve. Sa i përket rritjes ishte një rritje e shumëfishtë për shumë kategori të bizneseve nuk e di me çfarë arsye keni vendosur por kish deri në 10 fishë ose më shumë rritje të tarifave komunale e unë mendoj që kjo nuk është e duhur.

z.Bashkim Sylja, theksoi, mendoj se ishin disa vërejtje mirëpo për momentin ky është vetëm një propozim vendim për diskutim publik sqarimet dhe sugjerimet tjera merren gjatë debateve dhe sigurisht se do të ketë edhe ndryshime ky draft dokument sepse në këtë mënyrë siç ka ardhë ishin disa tarifa më të larta të cilat do t'i diskutojmë nesër.

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, vetëm një sqarim e kam debati për këtë rregullore do të jetë një muaj, rregullorja e vitit 2018, taksën për ushtrimin e veprimtarisë thuajse e ka pasë për çdo biznes që ka ushtruar ato veprimtari dhe ajo shumë buxhetore që ka qenë e grumbulluar apo ai obligim financiar e që pjesa dërmuese e tij ka qenë prej vitit 2000-2001, dhe një pjesë e madhe e bizneseve kanë qenë në listë fiktive të cilën e kanë përbërë ato biznese, ne e dimë se nuk ka asnjë procedurë ligjore për mbledhjen e këtyre obligimeve të vitit 2002, sepse ato parashkruhen prandaj këto borxhe vetëm kanë figuruar si të tilla, edhe herën e kaluar e pata sqaruar këtë çështje se këto obligime ju kanë shkaktuar vështirësi biznese kur iu është kërkuar ndonjë konfirmim nga institucionet përkatëse që nuk kanë obligime tatimore e zakonisht për çdo gjë ky konfirmim iu kërkohet bizneseve qoftë prej bakës apo për aplikim për subvencione apo për grande të ndryshme në ndonjë organizatë apo institucion. Tani në këtë propozim rregullore janë vetëm një kategori e caktuar e bizneseve që i nënshtrohen kësaj takse që janë kompanitë e sigurimit, bankat, qendrat e mëdha tregtare dhe disa kompani të telekomunikacionit. Sa i përket kompanive të sigurimit vitin e kaluar ka pasë një shqetësim tek agjentët e sigurimit të cilët janë në Komunën e Podujevës, kjo taksë nuk është për personat që veprojnë si agjent të sigurimit që kryesisht kompanitë e sigurimeve veprojnë në atë formë, kjo taksë është për atë kompaninë e sigurimit e cila ushtron aktivitet në komunën e Podujevës pa i përmendur me emra dhe pa ju bërë marketing të cilat janë kompani gjigante dhe të cilat kanë filiale në Podujevë e këto filiale zakonisht bëhen me agjent dhe ata vitin e kaluar kur kjo taksë u hedh poshtë nga asambleja komunale e kanë pasë atë shqetësim se po taksohen ata. Taksa prej 500€, për kompanitë e sigurimeve është taksë e madhe për agjentët kurse është taksë tepër e vogël për kompanitë e sigurimeve, kemi edhe një ndryshim te lejet e ndërtimit për objektet industriale ku këtë taksë e kemi lënë simbolike prej 18 centëve, mirëpo kjo vlen vetëm për objektet prodhuese e jo për objektet tjera. Në krahasim me rregulloren e vitit 2018, taksës pothuajse 90% të bizneseve nuk i nënshtrohen, është vetëm një numër i vogël i bizneseve që janë biznese të mëdha e që besoj se një taksë prej 500€ apo 1000€, për atë kategori biznesi është shumë e vogël por prapë se prapë në diskutim publik ju mirëpresim dhe nuk do të thotë se nuk ka ndonjë lëshim dhe s' do të thotë që s'ka propozime më të mira.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse s'ka anëtar tjerë të interesuar të Komitetit për ta marrë fjalën atëherë e vë në votim edhe këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar.

Pas votimit, me 5 vota PËR, ndërsa të tjerët nuk morën pjesë në votim, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të kësaj pike sipas materialit përkatës të dërguar, dhe që në mbledhjen e Kuvendit të propozohet kohëzgjatje e diskutimit publik përfshirë edhe datën/at e debatit/eve publike.

10. Raporti vjetor financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, sa i përket raportit financiar për vitin 2021 po ndërlihem me vërejtjen të cilën e patë asamblisti z.Naim Çunaku, që rrjedhimisht edhe në planin e punës është paraqit për muajin mars, është e vërtetë dhe rendi e parasheh që më së largu të paraqitet në muajin mars, mirëpo kemi pasur edhe një problem të pasqyra financiare ku së pari bilancin duhet ta përmbyllë Ministria e Financave në mënyrë që kur të bëhet raporti financiar pasqyrat financiare duhet të jenë të barazuara deri në zero. Ministria e Financave deri në fund të muajit mars apo në fillim të muajit prill nuk e kanë bërë bilancin përfundimtar, që pas kësaj duhen 2 ose 3 ditë pune që të barazohet bilanci, kështu që ka qenë e pa mundur që muajin mars edhe nëse ish mbajte ndonjë seancë të paraqitet raporti financiar i vitit 2021, andaj këtë pikë të rendit të ditës ia rakomandoj Kuvendit për diskutim.

z.Naim Çunaku, theksoi, është e vërtetë që ligji për vetëqeverisjen lokale nuk e përcakton gjegjësisht nuk kërkon e as nuk mohon opinionin e këshilltarëve, gjegjësisht votimin pro apo kundër raporteve periodike financiare dhe as raporteve vjetore dhe fundja sigurisht se ka dëshmitarë se më parë dikur unë i kam thënë se pavarësisht se çka vendosim ne ajo ec, nuk askush pasoja me përjashtim nëse ka pasoja apo shkelje ligjore që kanë të bëjnë me drejtësi por jo në Kuvend. Kur i potencova datat dhe shtyrjet e raportimeve në Kuvend nuk desha të jem decidivë që reagoj edhe z.Bashkim Sylja, pavarësisht planit nuk desha ta ngarkoj sepse ne e kemi pas të parashikuar këtë çështje me plan. Unë e di që plani i punës së Kuvendit nuk mund të bëhet në kundërshtim me rregulloren e Punës së Kuvendit dhe nuk guxon të bëhet plani i punës pa e pas planin e punës së ekzekutivit, në një formë ajo e përcakton agjendën e Kuvendit, por nëse jemi këtu të thirrur për zbatimin e ligjshmërisë pavarësisht situatave që krijohen shkelje ligjore ka, arsyeja pse me ligjin mbi financat lokale 31 marsi është data e fundit kur duhet të raportohet para Kuvendit. Ne sot nuk jemi në datën 31 mars andaj e thash këtë se është dashur të bëhet në seancën e muajit mars, e di se çfarëdo veprimi i këshilltarëve si votuan ose jo ajo procedurë vazhdon ec ashtu siç e ka paraparë ligji dhe unë nuk mundem të dal në diçka tjetër por shkelje ligjore ka.

znj.Adelina Stubulla, theksoi, mund të na sqaroni se për cilën periudhë kohore e keni fjalën kur janë bërë këto raportime në mënyrë precize, vetëm nëse janë bërë prej vitit 2013 e tutje përndryshe unë s'besoj se ka pasur precizitet ose specifikim të raportimit me kohë, diçka më duket absurde se ka ndodhur në seancat e viteve paraprake që kanë ardhë dhe kanë shkuar drejtorët por nuk kanë raportuar askund.

z.Naim Çunaku, theksoi, për hir të korrektesisë znj.Adelina Stubulla, nëse ne fillojmë me një praktikë të keqe që ka ndodhur dhe t'ju referohemi si arsyetim i një praktike që nuk ka qenë në rregull dhe ne të veprojmë njësoj si ata, mua kjo nuk më çon askund. Ne si shoqëri dhe gjithkush jep llogari për veprimet e tij andaj ne duhet të jemi të përgjegjshëm dhe duhet ta ndërtojmë dhe ta përparojmë një qeverisje komunale drejt një qeverisje të mirë që duhet t'i përfill ligjet për mua nuk është arsyetim se çka ka bërë ai në të kaluarën edhe pse taksativisht nuk e di saktë se çfarë ka ndodhur unë e thash një fjali një fjali me vetë faktin që nuk ka asnjë sanksion lidhur me raportin pavarësisht se a e votojmë ose jo këtë raport na e tregon fuqinë tonë karshi tyre.

z.Bashkim Sylja, theksoi, vendimet e Kuvendit Komunal deri më tani kanë pas mundësinë të miratohen heshtazi nga MAPL-ja, tani është obligative që çdo vendimi Komunal t'i jepet leja për miratim nga MAPL-ja. Sa i përket planit të punës të Kuvendit kurrë se pasqyron gjithë fushëveprimin e ekzekutivit, do

të thotë se ekzekutivi ka të drejtë të fusë pika të rendit të ditës pa qenë të përfshira në planin e punës, kështu asnjëherë plani i punës nuk ka qenë strikt se nuk mundet sepse del një seancë e jashtëzakonshme, apo ndonjë projekt madhor dhe gjithëherë rrethanat ndryshojnë prandaj plani i punës nuk ka qenë strikt asnjëherë për këtë arsye plani i punës mund të ndryshohet. Raportimet financiare kanë mund të mos jenë pika të rendit të ditës në një seanca, në këtë seancë pikë e rendit të ditës ka mundur të jetë raporti financiar kurse raporti 3 mujor janar-mars të jetë për seancën e radhës, përndryshe plani i punës 100%, nuk mund ta përcaktoj dinamikën e zhvillimit të qeverisjes nga ekzekutivi.

z.Naim Çunaku, theksoi, edhe një sqarim kur thash 31 marsi, është e vërtetë që herën e parë e përmenda planin e punës, mirëpo herën e dytë u bëra edhe më i saktë nuk e ceka planin e punës por e ceka ligjin për menaxhimin e financave lokale se çka ka në plan të punës dhe sa ka të drejtë me ik prej agjendës së përcaktuar me planin e punës këtë e rregullon rregullorja taksativisht, për këtë s'kam çka të flas hiç, kështu që kur e përmenda raportin financiar iu referova ligjit i cili e përcakton se raportimi para Kuvendit është data e fundit 31 marsi që në bazë të ligjit e kemi bërë edhe planin e punës në mënyrë që seanca e Kuvendit të thirret në muajin mars.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse s'ka anëtar tjerë të interesuar të Komitetit për ta marrë fjalën atëherë e vë në votim edhe këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar

Pas votimit, me 5 vota PËR, ndërsa të tjerët nuk morën pjesë në votim, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim të kësaj pike sipas materialit përkatës të dërguar.

11. Raporti financiar për periudhën janar – mars 2022

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, edhe këtë pikë të rendit të ditës i propozoj Kuvendit për diskutim në mbledhjen e radhës.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse s'ka anëtar tjerë të interesuar të Komitetit për ta marrë fjalën atëherë e vë në votim edhe këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim sipas materialit përkatës të dërguar.

Pas votimit, me 5 vota PËR, ndërsa të tjerët nuk morën pjesë në votim, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim të kësaj pike sipas materialit përkatës të dërguar.

12. Propozim Vendimi për pezullimin e përkohshëm të zbatimit të dispozitave Rregullore nr.prot.01-311/05-0007450/20 për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës të datës 31 janar 2020, dhe atë: neni 5 paragrafët 1.3; 2.3; dhe 4.4, neni 6 paragrafi 4, neni 7 paragrafi 2, neni 9 paragrafi 1.3, neni 12 paragrafi 2, neni 15 paragrafi 2.4; neni 16 paragrafi 2.3 dhe neni 17 paragrafi 2

z.Vigan Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE, theksoi, para jush keni këtë propozim vendim, arsyeshmëria e tij dihet sepse e keni marrë materialin dhe prej momentit kur e kemi dërguar në Kuvend këtë propozim kemi dy grupe të interesit prej të cilave njëri grup ka kërkuar që dita e diel të jetë ditë pune për biznese, kurse grupi tjetër i interesit ka kërkuar që puna e bizneseve të

vazhdoj në bazë të rregullores aktuale në fuqi, prandaj këtë propozim vendim i rekomandoj Kuvendit për shqyrtim pastaj Kuvendi të merr vendim e vet.

z.Naim Çunaku, theksoi, është e vërtetë se për këtë rregullore kur është pretenduar që me procedura urgjente të ndryshohet edhe atëherë kam thënë se së pari kjo rregullore duhet ta kalojë filtrin e ekzekutivit. Këtë rregullore e di se e kanë miratuar të gjitha grupet e këshilltarëve që kanë qenë në atë përbërje të atij mandati përjashtoj këshilltarin Qendrim Softolli, që se ka votuar këtë rregullore. Është e vërtetë se kjo rregullore e ka çrregulluar punën e bizneseve dhe ka mangësi të mëdha, mirëpo forma qysh është duke u trajtuar kjo rregullore dhe duke tentuar që të përmirësohet diçka nuk po më duket formë e dëshiruar apo forma më e mirë e mundshme. Tani e kanë kuptuar pjesa më e madhe apo pjesa dërmuese e bizneseve se në bazë të rregullores mbi orari e punës nuk përcaktohen të drejtat dhe pushimet e punëtorëve por këto rregullohen me ligjin e punës, krejt në fund kisha dashur të largohemi nga kjo formë qysh jemi duke e trajtuar një rregullore, gjegjësisht ju që jeni duke e trajtuar një lojë me orarin e bizneseve të komunës tonë. Unë mendoj se në një të ardhme të afërt se duhet ta bëjmë një rregullore të mirëfilltë të qëndrueshme në kohë, të pëlqyeshme për bizneset dhe të kënaqshme për konsumatorët, gjegjësisht për shërbyesit. Kjo formë që po pretendojmë se po rregullojmë diçka vetëm po shtyn apo po blen kohë dhe më bëri përshtypje një fjali e drejtorit jo pse e tha atë ai por është një realitet që po mbretëron në komunën tonë sepse në cilin do veprim që e marrim dikën do e hidhërojmë se disa janë mësuar që ditën e diele të pushojnë e disa të tjerëve ju ka penguar që dita e diele të jetë ditë pushimi, kështu që ne nuk e dimë se cilët janë më shumë dhe si të veprojmë. Unë mendoj se nëse vijmë deri te marrja e vendimit për pezullimin e rregullores të bëjmë një pezullim për një afat optimal deri në hartimin e një rregulloreje të re për një afat një muaj apo një muaj e gjysmë pastaj ta miratojmë një rregullore ashtu siç i duhet komunës tonë.

z.Vigan Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE, theksoi, faleminderit i nderuari z.Naim Çunaku, pajtohem plotësisht me atë thatë ju për atë arsye ne kemi kërkuar që deri më 30 shtator të jetë e pezulluar kjo rregullore dhe gjatë kësaj kohe ne do të punojmë si drejtori për ta sjellë një draft rregullore të re e cila kur të fuqizohet do ta shfuqizoj këtë rregullore e cila sot është në fuqi, do të kalojë përmes procedurave të diskutimit publik, kështu që ne do të vijmë me një rregullore të re pasi që të përfundoj muaji shtator, pse jemi ngutur me këtë proces është arsyeja se draftimi i rregullores së re merr kohë dhe kemi kohën kur në atdhe kthehen mërgimtarët dhe ne na është dashur që të ndërmarrim hapa pak më të shpejt sa i përket kësaj çështje.

z.Naim Çunaku, theksoi, drejtor këtë që po e them mos e merr si polemikë sepse para jush në mbledhjen e KPF-së më datë 28.02.2022, është ngutur dikush që ta bëjë këtë veprim pezullimin e rregullores, pastaj nuk e di pse u ndalua ai veprim dhe nuk e di se çka është për ngut pezullimi i kësaj rregulloreje sepse së pari z.Bashkim Sylja, nga subjekti i Pdk-së, propozoj pezullimin e kësaj rregulloreje pastaj i njëjti propozim kaloi në kuvend por u tërhoq si pikë e rendit të ditës por tash pas një muaji i njëjti propozim na vjen në këtë mbledhje dhe kjo po më duket një lloje loje por së fundi kjo është e drejtë e juaja.

z.Florent Hasani, theksoi, grupi i këshilltarëve të LVV-së, e mbështetë propozimin për pezullimin e përkohshëm të dispozitave të rregullores për orarin e punës së bizneseve, prej punës dëm s'ka, mendoj se deri në muajin shtator duhet të hartohet një rregullore e duhur që të funksionojë në mënyrën sa më të mirë për dy grupet e interesit që i ceku drejtori më lartë.

z.Vigan Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE, theksoi, ne me pezullimin e kësaj rregulloreje nuk jemi duke kërkuar nga ana e bizneseve që ata të punojnë apo të pushojnë gjatë ditës së diele, kurse sa i përket çështjes së konkurrencës mes bizneseve ne nuk jemi të thirrur për t'ua rregulluar atyre bizneseve sepse secili duhet dijë si ta menaxhoj biznesin e tij se zakonisht kemi kërkesa të tilla, mirëpo ne nuk jemi të thirrur për rregullimin e kësaj çështje.

z.Bashkim Sylja, theksoi, këtë rregullore për orarin e bizneseve kanë dy ose 3 komuna të Republikës së Kosovës dhe këtë si mostër Komuna e Podujevës e ka marrë nga Komuna e Mitrovicës në kohën e qeverisjes së z.Agim Bahtiri, unë mendoj se duhet të hartohet një rregullore e re dhe ta shfuqizojë këtë rregullore aktuale në fuqi, këto dispozitat që rregullojnë orarin e punës së bizneseve mund t'i pezullojmë deri në muajin shtator dhe është kohë optimale që mund të mbahet dëgjimi publik e pastaj të bëhet draft rregullorja e re dhe të sjellët për votim në Kuvend andaj edhe ne jemi të këtij mendimi.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse s'ka anëtar tjerë të interesuar të Komitetit për ta marrë fjalën atëherë e vë në votim edhe këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar.

Pas votimit, me 5 vota PËR, ndërsa të tjerët nuk morën pjesë në votim, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të kësaj pike sipas materialit përkatës të dërguar.

13. Informatë e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik

z.Vigan Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE, theksoi, nga ana juaj kërkoj që kjo pikë e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse s'ka anëtar tjerë të interesuar të Komitetit për ta marrë fjalën atëherë e vë në votim edhe këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim sipas materialit përkatës të dërguar.

Pas votimit, me 5 vota PËR, ndërsa të tjerët nuk morën pjesë në votim, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim të kësaj pike sipas materialit përkatës të dërguar.

14. Rishqyrtimi i Vendimit nr.01-020/04-0014613/22 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete, të miratuar nga Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2022

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, ky vendim është kthyer nga ministria për rishqyrtim ndoshta për një arsye të mos përfshirjes së një anëtari të komunitetit egjiptas, ne kemi bërë thirrjen publike dhe janë paraqitur thirrjes komuniteti ashkali, komuniteti rom anëtarët e të cilëve janë propozuar dhe janë votuar në Kuvend, mirëpo propozime nuk kemi pasur nga komuniteti egjiptas edhe pse thirrja ka qenë publike, kështu që më vonë ka ardhë një propozim nga ky komunitet andaj ne duhet ta përfshijmë edhe këtë anëtarë në përbërjen e Komitetit për Komunitete por duhet edhe njëherë ta vëjmë në votim përbërjen e Komitetit për Komunitete i cili ka qenë në përbërje prej 7 anëtarëve mirëpo tani me propozimin e ri bëhen 8 anëtarë dhe përbërja e tij duhet të jetë prej 9 anëtarëve andaj propozoj që edhe LDK-ja ta ketë një anëtarë si pjesë përbërëse e këtij komiteti e këtë anëtar mund ta propozoj sot ose në mbledhjen e radhës së Kuvendit, mirëpo më mirë do të ishte sot nga LDK-jë në mbledhjen e KPF-së ta kemi një propozim konkret dhe kemi një propozim, një kërkesë nga komuniteti egjiptas që znj.Sevdije Mustafa të jetë anëtare e Komitetit për Komunitete kështu që Komiteti për Komunitete do t'i ketë 9 anëtar.

z.Naim Çunaku, theksoi, edhe në këtë rast duhet të konsultohet udhëzimi administrativ se a kemi të drejtë që komitetit të përbëhet prej 9 anëtarëve, për këtë temë unë kam menduar se do të flitet në një seancë të ardhshme sepse e ju kam premtuar se do t'i shqyrtojmë ato pika të rendit të ditës ku ne pretendojmë se ka shkelje ligjore, gjegjësisht ku ka shkelje të statutit dhe të rregullores, e di që me shkeljen e statutit dhe rregullores nuk merret MAPL-ja, statuti është kushtetuta e një komune s'dua ta elaburoj se në cilin dhe

çka por ajo që ka ndodh të përjashtohet një komunitet i tërë në këtë rast komunitet është edhe një subjekt politik mendoj se nuk ka qenë me vend. Mendoj, pretendoj se jam i thirrur në statut që ka shkelje statutare ju kemi lënë me pa me reflektu por edhe tani forma qysh pretendohet me u zgjedhë nuk besoj se do të jetë e kënaqshme, arsyeja pse po e them një të vërtetë të madhe se grupi më i madh i këshilltarëve në këtë Kuvend i LDK-së me afro 14000 vota tani të barazohet me një subjekt tjetër politik në këtë rast me PDK-në që është e përfaqësuar në Kuvend me 4 këshilltar e LVV-ja me 13 këshilltar në Kuvend t'i ketë dy anëtar në Komitetin për Komunitete më duket se nuk është e qëlluar po fundja vendimin e marrim nesër sot nuk kemi propozim.

z.Bashkim Syla, theksoi, sa për informatë që e ceku z.Naim Çunaku, Komiteti për Komunitete i ka pasë 9 anëtar mandatin e kaluar kur isha pjesë e atij Komiteti.

z.Naim Çunaku, theksoi, me qëllimin e vetëm që e njëjta gjë mos të përsëritet edhe njëherë se e di që ka qenë edhe një herë praktikë më herët që Komiteti për Komunitete ti ketë 9 anëtar. Nuk guxoj të them apo të flas me këmbë ngulje por sa unë kam shfletuar udhëzimin më duket se përbërja e Komitetit duhet të jetë prej 5 anëtarëve minimumi dhe maksimumi prej 9 anëtarëve, kurse në ato komuna ku nuk jetojnë komunitetet anëtarët e tyre plotësohen nga shoqëria civile sa mua më përkujtohen është kështu, por fundja nëse nuk është kështu, është edhe më mirë, është e mirëseardhur përbërja e komitetit edhe prej 9 anëtarëve.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, shumica e anëtarëve të Komitetit për Komunitete duhet të jenë nga radhët e komuniteteve dhe jo nga anëtarët e Kuvendit që do të thotë se nëse janë 5 anëtarë nga rradhët e komuniteteve atëherë 4 anëtarë duhet të jenë nga radhët e Kuvendit, në qoftë se përbërja e Komitetit është prej 7 anëtarëve atëherë 4 anëtarë duhet të jenë nga radhët e komuniteteve kurse 3 anëtarë nga radhët e Kuvendit.

z.Naim Çunaku, theksoi, shpresoj të mos gabohemi i nderuari Kryesues.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, ne nuk kemi nevojë të gabojmë se nuk na duhet një dokument që vlerësohet nga MAPL-ja si i jashtëligjshëm, besoj se edhe Kuvendi dhe Komiteti janë të interesuar që dokumentet të mos na kthehen të jashtëligjshme, prandaj nëse s'ka anëtar tjerë të interesuar të Komitetit për ta marrë fjalën atëherë e vë në votim edhe këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për rishqyrtim përkatësisht për plotësim ndryshimin e përbërjes së Komitetit për Komunitete sipas Shkresës së MPL-së.

Pas votimit, me 5 vota PËR, ndërsa të tjerët nuk morën pjesë në votim, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Kuvendit të Komunës i rekomandohet për ri-shqyrtim, përkatësisht për plotësim ndryshimin e përbërjes së Komitetit për Komunitete sipas Shkresës së MPL-së.

15. Rishqyrtimi i Vendimit nr.prot.01-550/01-0014605/22 për shpërndarjen e druve të zjarrit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, të miratuar nga Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2022

z.Naim Çunaku, theksoi, e kam thënë më parë por këtë që po e them sot se në seancën e kaluar drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale është ngritë në këmbë dhe ka thënë se ju grupi i këshilltarëve të LDK-së se keni votuar këtë pikë të rendit të ditës kur jeni dëshmitarë se i kam thënë drejtor a e keni konsultuar bazën ligjore se mua më duket se baza ligjore nuk e lejon këtë send, më ka thënë se e kam konsultu bazën ligjore dhe e kam ditë që ky vendim kthehet sot dhe nuk është hera e parë që kthehen vendime të tilla, kaq kisha për të thënë.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, drejtori e ka pas qëllimin e mirë që ato dru t'ju shpërndahen familjeve në nevojë, sa për sqarim ajo deponi e druve gjendet në oborrin e ujësjellësit dhe

ka ankesa nga punëtorët e ujësjellësit se ato dru kanë filluar të kalben dhe ujërat sipërfaqësore po kalojnë në ujëra nëntokësor dhe shfaqet rreziku i ndotjes së ujit që ne e përdorim për pije, këtu qëndron problemi dhe për këtë arsye në procedurë të shpejt duhet të largohen ato dru prej oborrit të ujësjellësit.

z.Naim Çunaku, theksoi, sa për sqarim i nderuari Kryesues atë që e thash më parë nuk e ka thënë drejtori i DBPZHR, por e ka thënë një drejtor i cili s'ka qenë kompetent për atë vendim ka dalë në foltore duke thënë se ju Grupi i këshilltarëve të LDK-së, se keni votuar këtë propozim vendim për ndarjen e drurëve për familjet në nevojë e që kisha pas dëshirë që ai drejtor të jetë sot i pranishëm në këtë seancë.

z.Bashkim Sylja, theksoi, sa i përket rishqyrtimit të vendimit për shpërndarje të druve për familjet në nevojë sqarimet do të na japë Drejtori i DBPZHR, por sa kam njohuri unë e di që drejtori në Ministrinë përkatëse ka marrë informatë se drejtori ka të drejtë përmes Kuvendit të bëjë shpërndarjen e druve, rast të njëjtë e kemi Komunën e Ferizajt që ka bërë ndarjen e druve përmes Kuvendit dhe ai vendim nuk i është kthyer i jashtëligjshëm dhe në këtë rast nëse ky vendim është i jashtëligjshëm atëherë edhe vendimi i Komunës së Ferizajt duhet të jetë i jashtëligjshëm. Sigurisht drejtori në mbledhjen e radhës së Kuvendit do të na japë sqarime shtesë, mirëpo qëllimi i drejtorit ka qenë i mirë që ato dru t'ju ndahen familjeve në nevojë dhe nuk ka qenë qëllim si i herave të kaluara që- ka ndodh me i marrë e me i shitë ato dru me një çmim të ulët tani prapë me i marrë ato dru e me ua shitë shkollave me një çmim 2 ose 3 fish më të madh por në këtë rast qëllimi ka qenë shpërndarja e atyre druve për familjet në nevojë.

z.Naim Çunaku, theksoi, askush nuk pat dilemë apo dyshim për misionin dhe vullnetin e mirë të drejtorit se ku kanë me përfunduar ato dru por më pengon kjo jo se kam qenë pjesë e pushtetit se s'kam qenë kurrë pjesë e ekzekutivit por të thirrëni në praktikën e pushtetit të kaluar, ta lëmë more pushtetin e kaluar se ne jemi sot këtu, unë nuk di kur jemi dëshmitarë unë dhe ti se edhe pushtetit të kaluar njësoj kështu ju kanë kthyer vendimet dhe është marrë vendim tjetër. Nuk ka të drejtë asetet komunale me u falë sepse atë e përcakton ligji dhe nuk varet prej vullnetit e diçka që përcakton ligji përjashtohet vullneti.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, ashtu është por ne kemi marrë edhe një veprim tjetër ku kemi mbajtur një mbledhje të jashtëzakonshme dhe kemi marrë vendim për ndarjen e 70,000.00€, për pako ushqimore dhe higjienike për familjet në nevojë por për të njëjtin vendim ende nuk ka ardhë ndonjë konfirmim i ligjshmërisë nga ana e MAPL-së, dhe ai është një dokument që ka mbete peng në Ministri ku disa herë kemi bërë kërkesa dhe reagime, në këtë rast edhe unë në cilësinë e Kryesuesit të Kuvendit mirëpo ende nuk kemi marrë ndonjë përgjigje qoftë pozitive apo negative nga ana e Ministrisë.

z.Naim Çunaku, theksoi, edhe një sqarim nëse për vendim nuk kthehet brenda afatit kohor prej 30 ditëve vlerësimi i ligjshmërisë qoftë pozitiv ose negativ nga Ministria e Pushtetit Lokal ne i them se është pranë në heshtje dhe është gjithçka në rregull.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, i nderuari këshilltarë z.Naim Çunaku, faleminderit për këto sqarime beso që disa herë së bashku me zyrën ligjore i kemi shfletuar të gjitha ligjet që e rregullojnë këtë çështje sepse tani ka ndryshuar legjislativi dhe në bazë të një legjislativi është procedura që e cekët ju që pas 15 ditë të mos konfirmimit të ligjshmërisë mund ta publikosh aktin mirëpo tani ka ndryshuar rregullativa ligjore që e obligon Ministrinë e Pushtetit Lokal të kthejë konfirmimin e ligjshmërisë brenda 15 dite. Ne si Kuvend apo si Komitet për politikë dhe financa nuk kemi dëshirë që vendimet nga Ministria e Pushtetit Lokal të na kthehen të jashtëligjshme dhe çdo kontribut i dhënë nga secili anëtar i Kuvendit që një dokument të ketë bazë ligjore e falënderoj për përkrahje dhe për sqarime për secilën çështje sepse sqarimet nuk janë të tepërta asnjëherë, nëse s'ka anëtar tjerë të interesuar të Komitetit për ta marrë fjalën atëherë e vë në votim edhe këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për rishqyrtim.

Pas votimit, me 5 vota PËR, ndërsa të tjerët nuk morën pjesë në votim, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Kuvendit të Komunës i rekomandohet për ri-shqyrtim të vendimit.

16. Rishqyrtimi i vendimit nr.prot.01-354/02-0014599/22 datës 28.02.2022 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.01-354/02-0087371/18 datë 02.11.2018.

Shkresa nr. DL 1546-2/22 datë 25.03.2022 e Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, (bashkëngjitur në këtë Konstatim)

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, edhe kjo pikë e rendit të ditës është kthyer nga Ministria përkatëse me arsyetimin se objekti pushimorja për nxënës dhe fëmijë bonjak në fshatin Orllan nuk është në përputhje me hartën zonale dhe planin zhvillimor komunal edhe pse me profesion nuk jam jurist arsyetimi i dhënë për mua nuk ishte bindës sepse ai objekt ka qenë e ndërtuar kohë më parë, sa kuptoj unë në përputhje me hartën zonale duhet të jenë objektet që ndërtohen e jo ato që kanë qenë të ndërtuara.

z.Naim Çunaku, theksoi, ne vetëm mund ta anulojmë atë vendim, në mbledhjen e kaluar unë e kam mbështetur propozimin e znj.Adelina Stublla, që objekti i cekur të shndërrohet në shtëpi të pleqve mirëpo atë propozim e mbështes prapë.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, pas anulimit të këtij vendimi kjo pikë e rendit të ditës mund të vije prapë në kuvend e pastaj propozimin e znj.Adelina Stublla mund ta vejmë në votim.

z.Naim Çunaku, theksoi, vetëm mund të zhvillohet një procedurë e re se përndryshe kjo ka përfunduar për atë e pata dyshimin te harta zonale sepse si të ndërhyjmë në materie të saj ajo kthehet në pikën zero.

znj.Adelina Stublla, theksoi, edhe propozimi i z.Qendrim Softolli, ka qenë me vend.

z.Naim Çunaku, theksoi, edhe propozimi juaj ka qenë i duhuri mirëpo e tërhiqet sepse nuk u përshtatke me propozimin e subjektit tuaj politikë.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, vendimet që janë në të mirë të qytetarëve duhen të merren pa dallime partiake mirëpo në rastin tonë ky vendim po kthehet në pikën zero sepse kalon për shqyrtim në Kuvend pastaj anulohet, pastaj ne mund ta procedojmë prapë këtë pikë të rendit të ditës, nëse s'ka anëtar tjerë të interesuar të Komitetit për ta marrë fjalën atëherë e vë në votim edhe këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për rishqyrtim.

Pas votimit, me 5 vota PËR, ndërsa të tjerët nuk morën pjesë në votim, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Kuvendit të Komunës i rekomandohet për ri-shqyrtim të vendimit.

Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 15:05

Procesverbalin e mbajti

Osman Bajrami

Nr.Prot.01-060/04-0030207/22

**Podujevë,
27 prill 2022**

Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit

Hilmi Hoxha